

AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Billy&John"

Sot më datë 16 Qershor 2021, Ortaku i vetëm themelues:

Z. Berljano Sineci, i biri i Besnik, lindur në Billçë, më 23.08.1998, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me kartë identiteti nr. Personal J80823048S.

Ortaku, si më sipër i identifikuar deklaron se ka vendosur të themelojë shoqërinë

"Billy&John"

shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi si vijon.

Neni 1
Emertimi

Themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **"Billy&John"** Sh.p.k.,

Neni 2

Objekti

Shoqëria ka për objekt:

Shërbime marketingu on-line, kryesisht jashtë shtetit shqipëtar, si: webimarketing, ndërmjetësim tregëtar, shërbime telefonike, call center e contact center, konsulencë tregtare, teknologjike, informatike, programime, shitje, etj, shërbime on-line.

Neni 3

Selia

3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Njësia Administrative 6, Kashar, Ysberisht, Rruga Teodor Keko pranë Vila L, Pall.i firmës Klensi Shpk, Kati 2, - Tiranë - Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësie dhe të krijojë filiale në qytete të ndryshme të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin pa afat. Asamblea Ortakëve me vendim mund të vendosë një afat për kohëzgjatjen e Shoqërisë.

Neni 5

- informon Asamblenë e Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- pranimet në punë, pagat, largimet nga puna, masat disiplinore për vartësit, miratimin e kërkesave për largim nga puna;
- të emërojë financier e konsulentë për problemet e shoqërisë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare, tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore për aktivitetin e kryer nga shoqëria;
- të lidhi marrëveshje me të tretë në kufijtë e objektit të aktivitetit të shoqërisë dhe të kompetencave të përcaktuara nga ortakët;
- të shpërblehet për punën që kryen sipas marrëveshjes me ortakët themelues.
- të thërrasi asamblenë e përgjithshme, sipas dispozitave të përcaktuara në ligj;
- të kryejë veprime/tranzaksione në llogaritë rrjedhëse të shoqërisë me vlera të pakufizuara, përfshirë nënshkrimin e kontratave me të tretë.

6.2 Administrimi i shoqërisë me vendim të asamblesë së ortakëve mund të bëhet dhe nga një ose më shumë administratorë të cilët mund ta administrojnë së bashku ose veçmas shoqërinë sipas vendimit përkatës të asamblesë.

6.3 Administratori shkarkohet nga detyra nga asambleja e ortakëve në rastet si më poshtë:

- shkarkohet nga asambleja për shkak se nuk përmbush detyrat që i janë caktuar nga statuti dhe ligji, bën mungesa të pajustificuara për më shumë se tre muaj ose nuk është më i aftë për t'i përmbushur ato;

- jep dorëheqjen dhe ia komunikon atë asamblesë, jo më vonë se 30 ditë para datës së largimit.

Neni 7

Viti Financiar dhe Bilanci

7.1 Viti Financiar fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti. Përgjashtimisht për vitin e themelimit të Shoqërisë, viti financiar fillon nga data e themelimit deri më 31 Dhjetor 2018.

7.2 Në rast prishje dhe likuidimi të Shoqërisë, në çdo moment dhe për çdo arsye, emërimi i likuidatorit do të miratohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 8

Dispozitat e fundit

Ky akt-themelimi i shoqërisë "**Billy&John**" sh.p.k u hartua në bazë të vullnetit të lirë të themeluesit, në mbështetje të dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe u hartua në 4 (katër) kopje në

gjuhën shqipe, me të njejtën vlerë secila, me përjashtim në rast interpretimi ku versioni në gjuhën italiane do të mbizotërojë mbi atë shqipe, dhe u nënshkruan rregullisht nga ortakët e saj.

Ortaku i Vetëm themelues

Berljano Sineci

Berljano Sineci 